



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**PROJEKTLIGJI PËR LOJËRAT E FATIT**

**NACRT ZAKONA O IGRAMA NA SREĆU**

**DRAFT LAW ON GAMES OF CHANCE**



<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b>	<b>REPUBLIC OF KOSOVO</b>	<b>REPUBLIKA KOSOVO</b>
<b>KUVENDI</b>	<b>ASSEMBLY</b>	<b>SKUPŠTINA</b>
Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,	Based on Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo, hereby	Na osnovu člana 65. (1) Ustava Republike Kosova,
Miraton	Adopts	Usvaja
<b>LIGJ PËR LOJËRAT E FATIT</b>	<b>LAW ON GAMES OF CHANCE</b>	<b>ZAKON O IGRAMA NA SREĆU</b>
<b>KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME</b>	<b>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</b>	<b>I POGLAVLJE OPŠTE ODREDBE</b>
<b>Neni 1 Qëllimi</b>	<b>Article 1 Purpose</b>	<b>Član 1 Svrha</b>
1. Me këtë ligj rregullohet mënyra e organizimit, funksionimit dhe mbikëqyrjes së Lotarisë së Kosovës dhe ndalimi i ushtrimit të disa veprimtarive të lojërave të fatit.	1. This Law regulates the method of organization, functioning and supervision of the Lottery of Kosovo and prohibition of exercising some activities of Games of Chance.	1. Ovim zakonom uređuje se naćin organizovanja, funkcionisanja i nadgledanja Lutrije Kosova i zabrana vršenja određenih delatnosti igara na sreću.
2. Rregullon statusin, qeverisjen, menaxhimin dhe të drejtat e transferueshme dhe të përcaktuara të Lotarisë së Kosovës.	2. It regulates the status, governance, management and transferrable and assignable rights of the Lottery of Kosovo.	2. Reguliše se status, rukovođenje, upravljanje i prenosiva i utvrđena prava Lutrije Kosova.



<p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b> <b>Parimet themelore</b></p> <p>1. Ky ligj përcakton parimet themelore:</p> <p>1.1. Besimi dhe mirëbesimi i publikut se Lotaria e Kosovës nuk është lidhur me elemente kriminale dhe korrupsion;</p> <p>1.2. Ndalimi i disa veprimtarive të lojërave të fatit bëhet për të ruajtur shëndetin, sigurinë, moralin, rendin publik dhe mirëqenien e përgjithshme, për parandalimin dhe luftimin e varësisë nga lojërat, për mbrojtjen e të rinjve, për parandalimin dhe luftimin e shpëlarjes së parasë,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2</b> <b>Basic principles</b></p> <p>1. This Law defines the basic principles:</p> <p>1.1. the public confidence and trust that the Lottery of Kosovo is not linked with criminal and corrupted elements;</p> <p>1.2. prohibition of some activities of Games of Chance is made in order to protect the health, security, moral, public order and overall welfare, for prevention and fighting the dependence on games, protection of youth, prevention and fighting of money laundering.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 2</b> <b>Osnovna načela</b></p> <p>1. Ovaj zakon utvrđuje osnovna načela:</p> <p>1.1. Poverenje i razumevanje javnosti da Lutrija Kosova nije povezana sa kriminalnim i koruptivnim elementima;</p> <p>1.2. Zabrana određenih delatnosti igara na sreću čini se u cilju očuvanja zdravlja, sigurnosti, morala, javnog reda i opšteg blagostanja, za sprečavanje i borbu protiv zavisnosti od igara na sreću, za zaštitu mladih, za sprečavanje i borbu protiv pranja novca.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 3</b> <b>Përkufizimet</b></p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:</p> <p>1.1. <b>ATK</b> - Administratën Tatimore të Kosovës.</p> <p>1.2. <b>Lotaria tradicionale</b> – lojërat e fatit që përfshijnë shitjen e tiketave të paranimëruara tek pjesëmarrësit dhe numrat identifikues që fitojnë fitimet e paracaktuara nëpërmjet tërheqjes në kohë të</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3</b> <b>Definitions</b></p> <p>1. Terms used in this Law shall have the following meaning:</p> <p>1.1. <b>TAK</b> – the Tax Administration of Kosovo.</p> <p>1.2. <b>Traditional Lottery</b> – the Games of Chance including the sale of pre-numbered tickets to participants and identifying numbers that win pre-determined prizes through draws made at pre-specified times.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3</b> <b>Definicije</b></p> <p>1. Izrazi upotrebljeni u ovom zakonu imaju sledeća značenja:</p> <p>1.1. <b>PAK</b> – Poreska administracija Kosova.</p> <p>1.2. <b>Tradicionalna lutrija</b> – igre na sreću koje uključuju prodaju karata prenumerisanja i identifikacionih brojeva koji dobijaju pred-određene dobiti kroz</p>



<p>para-caktuar.</p> <p>1.3. <b>Lojërat numerike</b> – lojërat si keno, lotto, bingo, etj., ku pjesëmarrësit zgjedhin një set të numrave, figurave, shkronjave dhe/apo simboleve që vendosen në një tërheqje për të përcaktuar setin fitues dhe pjesëmarrësit fitues ndajnë fitimin e caktuar si një përqindje e caktuar e qarkullimit.</p> <p>1.4. <b>Lojërat instant</b> – lojëra që të mundësojnë të fitosh një fitim instant duke e zbuluar apo hapur rubrikën e fshehur të tiketës dhe duke gjetur një numër të caktuar të grupeve identike të figurave, numrave, shkronjave dhe/apo simboleve.</p> <p>1.5. <b>Lojërat e lotarisë</b> – lotarinë tradicionale, lojërat numerike, lojërat instant dhe lojërat e ngjashme ku rezultatet bazohen plotësisht në rastësi.</p> <p>1.6. <b>Bordi menaxhues</b> – autoriteti menaxhues të Lotarisë së Kosovës.</p> <p>1.7. <b>Komisioni</b> – një grup të personave të emërtuar nga organizatori për qëllim të tërheqjes së fitimeve në lojërat e lotarisë.</p> <p>1.8. <b>Drejtori</b> - drejtori i përgjithshëm i</p>	<p>1.3. <b>Numerical Games</b> – games such as keno, lotto, bingo, etc. in which the participants select a set of numbers, figures, letters and/or symbols which are entered into a draw to determine the winning set and winning participants share the prize set as a certain percentage of the turnover.</p> <p>1.4. <b>Instant Win Games</b> – games which allow you to win a prize instantly by scratching or opening concealed sections of the ticket and finding a certain number of identical figures, numbers, letters and/or symbol groups.</p> <p>1.5. <b>Lottery Games</b> – traditional lottery, numerical games, instant win games and similar games in which the results are based purely on chance.</p> <p>1.6. <b>Managing Board</b> – the managing authority of the Lottery of Kosovo.</p> <p>1.7. <b>Commission</b> – the group of persons nominated by the organizer for the purpose of withdrawal of winnings in Lottery Games.</p> <p>1.8. <b>Director</b> – the general director of TAK.</p>	<p>izvlačenje u unapred određenom vremenu.</p> <p>1.3. <b>Numeričke igre</b> – igre kao keno, lotto, bingo i dr., gde učesnici biraju skup brojeva, figura, slova i/ili simbola koji se postavljaju u jedno izvlačenje da bi se utvrdio dobitnički set i porednički učesnici dele određenu dobit kao određeni procenat prometa.</p> <p>1.4. <b>Instant igre</b> - igre koje omogućavaju ostvarivanje instant dobiti, otkrivajući ili otvarajući skrivenu rubriku tiketa i pronalaženjem određenog broja identičnih grupa figura, brojeva, slova i/ili simbola.</p> <p>1.5. <b>Igre lutrije</b> – tradicionalna lutrija, numeričke igre, instant igre i slične igre gde se rezultati zasnivaju isključivo na sreću.</p> <p>1.6. <b>Upravni odbor</b> – upravni organ Lutrije Kosova.</p> <p>1.7. <b>Komisija</b> – grupa lica imenovanih od strane organizatora u cilju izvlačenja dobitaka u lutrijskim igrama.</p> <p>1.8. <b>Direktor</b> – generalni direktor PAK-a.</p>
--	---	---



<p>ATK-së.</p> <p>1.9. <b>Organizatori</b> – subjektin ligjor, që ekskluzivisht organizon dhe menaxhon të gjitha aktivitetet e ndërlidhura me lojërat e fatit në Republikën e Kosovës, bazuar në licencën ekskluzive dhe autoritetin e dhënë nga ATK-ja.</p> <p>1.10. <b>Pjesëmarrësi</b> – një person që luan lojëra të fatit nëpërmjet dilerëve dhe lojërave të kazinosë në kazino.</p> <p>1.11. <b>Tiketa</b> – letra e printuar dhe special të disenjuar që aprovon të drejtën për pjesëmarrje në lojëra të fatit.</p> <p>1.12. <b>Qarkullimi</b> – shuma monetare të mbledhur nga pjesëmarrësit nga pjesëmarrja në lojëra të fatit.</p> <p>1.13. <b>Çmimi</b> – shuma monetare që duhet t'i paguhet pjesëmarrësve fitues..</p> <p>1.14. <b>Lojërat e fatit</b> – nënkuptojnë lojrat sipas nenit 11 të këtij ligji.</p> <p>1.15. <b>Mjetet e lojërave të fatit</b>- çdo pajisje, pjesë përbërëse ose makinë që përdoret për lojëra të fatit, që ndikon mbi rezultatet e lojës duke vendosur mbi humbjet ose fitoret siç përcaktohet me</p>	<p>1.9. <b>Organizer</b> – the legal entity, exclusively organizing and managing all activities related to Games of Chance in the Republic of Kosovo, based upon the exclusive license and authority granted by TAK.</p> <p>1.10. <b>Participant</b> – a person playing Games of Chance through dealers and casino games in casinos.</p> <p>1.11. <b>Ticket</b> – the specially designed printed paper approving the participation right in Games of Chance.</p> <p>1.12. <b>Turnover</b> – the monetary amount collected from the participants in return for playing Games of Chance.</p> <p>1.13. <b>Prize</b> – the monetary amount to be paid to winning participants.</p> <p>1.14. <b>Games of Chance</b> – games according to Article 11 of this Law.</p> <p>1.15. <b>Devices of Games of Chance</b> – any equipment, integral part or machine which is used for Games of Chance, having an impact on results of the Games deciding about losing or winning as defined by internal rules</p>	<p>1.9. <b>Organizator</b> – pravni subjekat, koji isključivo organizuje i rukovodi sve aktivnosti vezane za igre na sreću u Republici Kosova, bazirajući se na isključivu licencu i ovlašćenje dato od PAK.</p> <p>1.10. <b>Učesnik</b> – osoba koja igra igre na sreću putem dilera i kazino-igara u kazino.</p> <p>1.11. <b>Tiket</b> – štampana i specijalna dizajnirana kartica koja odobrava pravo učešća u igrama na sreću.</p> <p>1.12. <b>Promet</b> – iznos novca prikupljen od učesnika učešćem u igrama na sreću.</p> <p>1.13. <b>Cena</b> – iznos novca koji treba da se isplaćuje učesnicima dobitnicima.</p> <p>1.14. <b>Igre na sreću</b> – znače igre shodno člana 11. ovog zakona</p> <p>1.15. <b>Sredstva igara na sreću</b> – svaka oprema, sastavni deo ili mašina koja se koristi za igre na sreću, koja utiče na rezultate, odlučujući o gubicima ili dobitcima, kako je utvrđeno unutrašnjim</p>
--	--	--



<p>regulla të brendshme nga ATK-ja.</p> <p>1.16. <b>Prodhuesi</b> - një person që prodhon, disenjon, monton, programon ose modifikon një mjet lojërash fati.</p> <p>1.17. <b>Person</b> - çdo person fizik ose juridik.</p> <p>1.18. <b>Publicitet</b> – çdo formë njoftimi për promovimin e lojërave të fatit, qëllimi i dukshëm i së cilës është dhënia e informacionit publikut në mediet e shkruara dhe audiovizive, duke përfshirë por jo kufizuar në gazeta, revista, televizion, radio, posterë, broshura dhe postë direkte.</p> <p>1.19. <b>Person i regjistruar</b> - çdo person të cilit i është lëshuar një regjistrim i vlefshëm nga ATK-ja në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të lëshuara nga MF-ja.</p> <p>1.20. <b>MF</b> - Ministria e Financave.</p> <p>1.21. <b>Rregullat e lojës</b> – dokument i përgatitur nga organizatori edhe aprovuar nga ATK-ja, që përfshin të gjitha termet e lidhura me instruksionet si të luhet një lojë fati, metodat e kalkulimit të fitimit të lidhur me çdo lojë, shpërndarjen e fitimit</p>	<p>issued by TAK.</p> <p>1.16. <b>Manufacturer</b> – a person, who manufactures, designs, installs, programs, or modifies a device of Games of Chance.</p> <p>1.17. <b>Person</b> – any natural person or legal entity.</p> <p>1.18. <b>Advertisement</b> – any form of notification for promotion of Games of Chance, which purpose is to inform the public by means of written or audio visual media, including but not limited to newspapers, magazines, television, radio, billboards, brochures and direct mail.</p> <p>1.19. <b>Registered Person</b> – any person to whom a valid Registration is issued by TAK in compliance with this Law and sub-legal acts issued by MF.</p> <p>1.20. <b>MF</b>- Ministry of Finance.</p> <p>1.21. <b>Game Rules</b> – the document prepared by the organizer and approved by TAK, which includes all the terms related to the how-to-play instructions for Games of Chance, calculation methods of the prize related to each game, the distribution of the</p>	<p>pravilima PAK-a.</p> <p>1.16. <b>Proizvođač</b> – lice koje proizvodi, dizajnira, montira, programira ili modifikuje jedno sredstvo igara na sreću.</p> <p>1.17. <b>Lice</b> – svako fizičko ili pravno lice.</p> <p>1.18. <b>Publicitet</b> - osvaki oblik obaveštenja o promociji igara na sreću, čiji je očigledan cilj pružanje informacija u štampanim ili audio-vizuelnim medijima, uključujući, ali ne ograničavajući se na novine, časopise, televiziju, radio, postere, brošure i direktnu poštu.</p> <p>1.19. <b>Registrovano lice</b> – svako lice kome je izdata važeća registracija od PAK-a u skladu sa ovim zakonom i podzakonskim aktima izdatim od MF-a.</p> <p>1.20. <b>MF</b> - Ministarstvo finansija.</p> <p>1.21. <b>Pravila igre</b> – dokument pripremljen od strane organizatora i odobren od PAK-a, koji obuhvata sve termine u vezi instrukcija kako da se igra jedna igra na sreću, metode izračunavanja dobiti u vezi svake igre, raspodelu dobiti između učesnika i sve ostale termine u vezi sa</p>
---	--	---



<p>ndërmjet pjesëmarrësve dhe të gjitha termet tjera në lidhje me lojërat e fatit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b> <b>Lojërat e fatit – kategorizimi dhe rregullimi</b></p> <p>1. Lojërat e fatit rregullohen sipas këtij ligji.</p> <p>2. ATK-ja është autoriteti rregullativ i lojërave të fatit.</p> <p>3. Lojërat e fatit janë lojërat e përcaktuara me nenin 11 të këtij ligji.</p> <p>4. Lojërat e kazinos, bastet sportive, lojërat në automate, tombola bingo në lokalet e mbyllura, lojërat elektronike, lojërat online përmes internetit, hipodromet, dhe lojërat me korrespondencë të themeluara në progresion gjeometrik, me korrespondencë dhe me pagesa të shumave të caktuara, të gjitha lojërat e quajtura piramidale, dhe të gjitha lojërat e tjera të cilat nuk janë në paragrafin 1. të këtij neni, janë të ndaluara me këtë ligj.</p>	<p>prize among participants and all other terms with regards to the Games of Chance.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4</b> <b>Games of Chance – Categorization and Regulation</b></p> <p>1. Games of Chance are regulated according to this Law.</p> <p>2. TAK is the regulative authority of Games of Chance.</p> <p>3. Games of Chance are games defined in Article 11 of this Law.</p> <p>4. Casino games, sports betting, slot machine games, tombola bingo in closed premises, electronic games, online games through internet, hippodromes, and correspondence games established in geometric progression, with correspondence and with payments of specific sums, all the games called pyramidal, and all other games which are not in paragraph 1. of this Article are forbidden by this Law.</p>	<p>igrama na sreću.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4</b> <b>Igre na sreću – kategorizacija i regulisanje</b></p> <p>1. Igre na sreću regulišu se ovim zakonom.</p> <p>2. PAK je regulatorni autoritet igara na sreću.</p> <p>3. Igre na sreću su igre utvrđene članom 11. Ovog zakona.</p> <p>4. Kasino igre, sportske kladionice, igre u slot-mašinama, tombola bingo u zatvorenim prostorijama, elektronske igre, online igre preko Interneta, hipodromi i igre prepiska osnovane geometrijskom progresijom, prepiskom i uplatama određenih iznosa, sve igre nazvane piramidinim i sve druge vrste igara, koje nisu u stavu 1. ovog člana, zabranjene su ovim zakonom.</p>
--	---	--



<b>Neni 5 Lojërat zbavitëse dhe konkurset shpërblyese</b>	<b>Article 5 Amusement games and award competitions</b>	<b>Član 5 Zabavne igre i nagradne igre</b>
<p>1. Lojërat zbavitëse siç janë lojërat në kalkulator, simulator, automatë, flipër, si dhe lojërat që vihen në lëvizje nëpërmjet parave metalike apo të zhetonëve në të cilat lojtari nuk mund të fitojë para, gjëra apo të drejta, nuk janë lojëra të fatit sipas këtij ligji.</p> <p>2. Konkurset shpërblyese që i organizon subjekti juridik me qëllim publiciteti nuk janë lojëra të fatit në pajtim me këtë ligj dhe mund të organizohen me kusht që pjesëmarrja në lojë të mos inkasohet dhe të mos ketë kosto shtesë.</p> <p>3. Shpërblimet nga paragrafi 2. i këtij neni mund të jepen në produkte, shërbime ose në para të gatshme. Shpërblimet në para të gatshme nuk mund të tejkalojnë shumën prej njëmijë euro (1,000.00) € për person dhe pagesa në para të gatshme obligohet të bëhet në llogarinë bankare të fituesit.</p> <p>4. Subjekti i cili organizon lojën shpërblyese i ofron rregullat e lojës shpërblyese të cilat miratohen nga ATK-</p>	<p>1. Amusement games such as games in calculator, simulator, automatic devices, flipper, as well as the games which are activated by coins or tokens in which the player cannot win money, items or rights, are not Games of Chance according to this Law.</p> <p>2. Awarding competitions organized by the legal entity for advertisement purposes are not Games of Chance according to this Law and they can be organized provided that the participation in the game is not cashed and does not have additional costs.</p> <p>3. Compensation from paragraph 2. of this Article can be given in products, services or in cash. Compensations in cash cannot exceed the amount of one thousand (1,000.00) Euro per person and the payment in cash is obliged to be made through the bank account of the winner.</p> <p>4. The entity which organizes the awarding game offers the rules of the game which are approved by TAK according to the</p>	<p>1. Zabavne igre, kao što su igre kalkulatora, simulatora, slot-mašinama, flipera, kao i igre koje se pokreću metalnim novcem ili žetonima, u kojima igrač ne može dobiti novac, stvari ili prava, nisu igre na sreću shodno ovom zakonu.</p> <p>2. Nagradne igre, koje organizuje pravni subjekat radi publiciteta nisu igre na sreću u skladu sa ovim zakonom i mogu se organizovati pod uslovom da se učešće u igri ne naplaćuje i da nema dodatnih troškova.</p> <p>3. Nagrade iz stava 2. ovog člana mogu se davati u proizvodima, u uslugama ili u gotovini. Nagrade u gotovini ne mogu preći iznos od hiljadu (1,000.00) € po osobi i plaćanje u gotovini obavezno je da se izvrši u bankarski račun dobitnika.</p> <p>4. Subjekt koji organizuje nagradnu igru pruža pravila igre koja se odobravaju od strane PAK-a u skladu sa odgovarajućim</p>





<p>ja në pajtim me aktin nënligjor përkatës të lëshuar nga MF-ja dhe të cilat duhet të shpallen në shtypin ditor.</p> <p style="text-align: center;"><b>KREU II</b> <b>LOTARIA E KOSOVËS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Themelimi dhe statusi</b></p> <p>1. Lotaria e Kosovës është subjekt juridik publik me status të ndërmarrjes publike siç përcaktohet me Ligjin për ndërmarrjet publike. Organizimi dhe funksionimi si ndërmarrjes i nënshtrohet rregullave të Ligjit për ndërmarrjet publike, përveç në rastet kur parashihet ndryshe me këtë ligj. Në rast të konfliktit të dispozitave ligjore të këtij Ligji dhe Ligjit për ndërmarrjet publike, dispozitat e këtij ligji kanë përparësi</p> <p>2. Qeveria merr përgjegjësi për të gjitha detyrimet e themeluesit të Lotarisë së Kosovës.</p> <p>3. Lojërat e lotarisë organizohen vetëm nga Lotaria e Kosovës sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj.</p> <p>4. Pagesa e fitimeve nga lojërat e fatit të cilat i organizon Lotaria e Kosovës,</p>	<p>corresponding sub-legal act issued by MF which shall be published in daily papers.</p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER II</b> <b>LOTTERY OF KOSOVO</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Establishment and Status</b></p> <p>1. The Lottery of Kosovo is a public-legal entity with status of a public enterprise as defined by the Law on Publicly Owned Enterprises. Organization and functioning as the enterprise is subject of the rules of the Law on Publicly Owned Enterprises, except in cases when it is foreseen otherwise by this Law. In cases of contravention of legal provisions of this Law and the Law on Publicly Owned Enterprises, provisions of this Law have priority.</p> <p>2. The Government undertakes the responsibility for all obligation of the founder of the Lottery of Kosovo.</p> <p>3. The Lottery Games are organized only by the Lottery of Kosovo according to the conditions defined by this Law.</p> <p>4. The payment of profits won at the Games of Chance organized by the Lottery of</p>	<p>podzakonskim aktom, izdatim od MF-a i koja se moraju objavljivati u dnevnoj štampi.</p> <p style="text-align: center;"><b>II POGLAVLJE</b> <b>LUTRIJA KOSOVA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Osnivanje i status</b></p> <p>1. Lutrija Kosova je javni pravni subjekt sa statusom javnog preduzeća, kako je utvrđeno zakonom o javnim preduzećima. Organizacija i funkcionisanje kao preduzeće podleže pravilima zakona o javnim preduzećima, osim u slučajevima kada se ovim zakonom drugačije predviđa. U slučaju konflikta zakonskih odredaba ovog zakona i Zakona o javnim preduzećima, odredbe ovog zakona imaju prednost.</p> <p>2. Vlada preuzima odgovornost za sve obaveze osnivača Lutrije Kosova.</p> <p>3. Lutrijske igre organizuju se samo od strane Lutrije Kosova, prema uslovima propisanim ovim zakonom.</p> <p>4. Isplata dobiti od igara na sreću koje organizuje Lutrija Kosova, garantuje se od</p>
---	---	---



<p>garantohet nga Qeveria e Kosovës.</p> <p>5. Veprimtaria e Lotarisë së Kosovës është ushtrimi i lojërave të fatit, në pajtim me këtë ligj, për ushtrimin e të cilave Lotarisë së Kosovës nuk i kërkohet leje e veçantë nga ATK-ja.</p> <p>6. Lotaria e Kosovës është e detyruar që të mundësojë mbikëqyrjen e tërë procesit material dhe financiar në baza ditore nga ana e ATK-së.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Organizimi dhe menaxhimi</b></p> <p>1. Autoriteti menaxhues i Lotarisë së Kosovës është Bordi Menaxhues, i cili i ka pesë (5) anëtarë.</p> <p>2. Anëtarët e Bordit Menaxhues i propozon dhe i emëron Qeveria me mandat dy (2) vjeçar.</p> <p>3. Anëtarët e Bordit Menaxhues nuk mund të jenë:</p> <p>3.1. zyrtarë të lartë të Qeverisë;</p> <p>3.2. udhëheqës të lartë të partive politike;</p> <p>3.3. personat që kanë bashkëshortin-ën ose anëtarët e familjes së ngushtë në</p>	<p>Kosovo, are guaranteed by the Government of Kosovo.</p> <p>5. The activity of the Lottery of Kosovo is to exercise Games of Chance, in accordance with this Law, for exercising of which no special permit is required for the Lottery of Kosovo by TAK.</p> <p>6. The Lottery of Kosovo is obliged to enable the daily monitoring of entire financial and material process by TAK.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Organization and Management</b></p> <p>1. The managing authority of the Lottery of Kosovo is the Managing Board which has five (5) members.</p> <p>2. The members of the Managing Board are proposed and nominated by the Government with a two (2) years mandate.</p> <p>3. The following cannot be members of the Managing Board:</p> <p>3.1. senior officers of the government;</p> <p>3.2. senior managers of political parties;</p> <p>3.3. persons whose spouse or close family member holds a high position at the Lottery</p>	<p>Vlade Kosova</p> <p>5. Delatnost Lutrije Kosova je vršenje igara na sreću, u skladu sa ovim zakonom, za čije vršenje Lutriji Kosova nije potrebna posebna dozvola od PAK-a.</p> <p>6. Lutrija Kosova je obavezna da obezbedi nadzor celokupnog materijalnog i finansijskog procesa na dnevnim osnovama od PAK-a.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Organizacija i upravljanje</b></p> <p>1. Autoritet upravljanja Lutrije Kosova je Upravni odbor, koji ima pet (5) članova.</p> <p>2. Članove Upravnog odbora predlaže i imenuje Vlada sa mandatom od dve (2) godine.</p> <p>3. Članovi Upravnog odbora ne mogu biti:</p> <p>3.1. visoki zvaničnici Vlade;</p> <p>3.2. visoki rukovodioci političkih stranaka;</p> <p>3.3. lica kojima su bračni drugovi ili članovi uže porodice na visokim</p>
---	---	--



<p>funksiione të larta në Lotarinë e Kosovës.</p> <p>4. Anëtarët e Bordit Menaxhues kanë statusin e tyre në bazë të legjislacionit në fuqi në momentin e emërimit.</p> <p>5. Bordi Menaxhues do të kryesohet nga Kryetari i cili zgjidhet gjatë procesit të emërimit sipas paragrafit 2 të këtij neni i cili njëherit do të jetë edhe anëtar i Bordit Menaxhues.</p> <p>6. Qeveria mund të liroj nga puna një anëtar të Bordit Menaxhues para se t'i skadojë afati i mandatit nëse:</p> <p>6.1. ofron dorëheqjen;</p> <p>6.2. i keqpërdor të drejtat e tij; dhe</p> <p>6.3. dënohet me tepër se gjashtë (6) muaj për ndonjë vepër penale sipas ligjeve në fuqi.</p> <p>7. Kryetari i Bordit Menaxhues të Lotarisë së Kosovës, funksionet e veta i ushtron në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të Lotarisë së Kosovës, funksionet e të cilit më afër përcaktohen me statutin e Lotarisë së Kosovës.</p>	<p>of Kosovo.</p> <p>4. The members of the Managing Board have their status based on the legislation in power at the moment of their nomination.</p> <p>5. The Managing Board will be chaired by the President who is elected during the appointment process in accordance with paragraph 2. of this Article, who at the same time shall be a member of the Managing Board.</p> <p>6. The Government can dismiss from work a member of the Managing Board before the expiration of the mandate if:</p> <p>6.1. he resigns;</p> <p>6.2. abuses his rights; and</p> <p>6.3. is sentenced for more than six (6) months for any criminal offence according to the Laws in power.</p> <p>7. The President of the Managing Board practices his activities in the title of the legal representative of the Lottery of Kosovo, the functions of whom are defined in detail with the Status of Lottery of Kosovo.</p>	<p>pozicijama u Lutriji Kosova.</p> <p>4. Članovi Upravnog odbora imaju svoj status u skladu sa važećim zakonodavstvom u vreme imenovanja.</p> <p>5. Upravnim odborom će predsedavati predsednik, koji se bira tokom procesa imenovanja shodno stava 2. ovog člana, koji će istovremeno biti i član Upravnog odbora.</p> <p>6. Vlada može osloboditi od posla jednog člana Upravnog odbora pre isteka mandata ako:</p> <p>6.1. daje ostavku;</p> <p>6.2. zloupotrebljava svoja prava; i</p> <p>6.3. bude kažnjen za više od šest (6) meseci za krivično delo prema važećim zakonima.</p> <p>7. Predsednik Upravnog odbora Lutrije Kosova, svoje funkcije obavlja u svojstvu pravnog zastupnika Lutrije Kosova, čije se funkcije bliže definišu Statutom Lutrije Kosova.</p>
---	--	---



<b>Neni 8 Statuti i Lotarisë së Kosovës</b>	<b>Article 8 The Statute of the Lottery of Kosovo</b>	<b>Član 8 Statut Lutrije Kosova</b>
<p>1. Lotaria e Kosovës e ka statutin me të cilin përcakton dhe rregullon:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1.1. firmën dhe selinë;</li><li>1.2. veprimtarinë;</li><li>1.3. kapitalin themelor;</li><li>1.4. sasinë, disponimin dhe tërheqjen e depozitave nga kapitali themelor;</li><li>1.5. ndarjen e fitimeve dhe sistemimin e të ardhurave;</li><li>1.6. bartjen e rreziqeve dhe të humbjeve;</li><li>1.7. administrimin, caktimin, shkarkimin, autorizimin, përgjegjësinë dhe pagimin e punëtorëve të caktuar;</li><li>1.8. organizimin e brendshëm;</li><li>1.9. çështjet statutores;</li><li>1.10. kohëzgjatjen dhe mbarimin e veprimtarisë si dhe çështjet e tjera të cilat dalin nga ligji për ushtrimin e veprimtarisë së Lotarisë.</li></ol> <p>2. Statutin e Lotarisë së Kosovës e propozon Bordi Menaxhues i Lotarisë së Kosovës, të cilin e miraton Qeveria e Kosovës.</p>	<p>1. The Lottery of Kosovo has a statute by which it particularly defines and regulates:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1.1. its firm and legal seat;</li><li>1.2. its activity;</li><li>1.3. the basic capital;</li><li>1.4. the quantity, availability and withdrawal of deposits from the basic capital;</li><li>1.5. sharing of earnings and the systematization of income;</li><li>1.6. bearing responsibility for risks and losses;</li><li>1.7. the administration, appointment, discharge, authorization, responsibility and the payment of assigned employees;</li><li>1.8. internal organization;</li><li>1.9. status issues;</li><li>1.10. the duration and termination of the activity and other issues which derive from the Law for exercise of the Lottery activity.</li></ol> <p>2. The statute of the Lottery of Kosovo is proposed by Managing Board of the Lottery of Kosovo, which is approved by the Government of Kosovo.</p>	<p>1. Lutrija Kosova ima statut koji definiše i reguliše:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1.1. firmu i sedište;</li><li>1.2. delatnost;</li><li>1.3. osnovni kapital;</li><li>1.4. količina, dostupnost i povlačenje depozita iz osnovnog kapitala;</li><li>1.5. podela dobiti i raspoređivanje prihoda;</li><li>1.6. snošenje rizika i gubitaka;</li><li>1.7. upravljanje, određivanje, razrešenje, ovlašćenje, odgovornost i plaćanje određenih radnika;</li><li>1.8. unutrašnja organizacija;</li><li>1.9. statusna pitanja;</li><li>1.10. trajanje i prestanak delatnosti, kao i druga pitanja koja proističu iz zakona o vršenju delatnosti Lutrije.</li></ol> <p>2. Statut Lutrije Kosova predlaže Upravni bord Lutrije Kosova, koji usvaja Vlada Kosova.</p>
<b>Neni 9 Kompetencat e Bordit Menaxhues</b>	<b>Article 9 Competencies of the Manging Board</b>	<b>Član 9 Ovlašćenja Upravnog odbora</b>
1. Bordi Menaxhues i Lotarisë së	1. The Managing Board of the Lottery of	1. Upravni odbor Lutrije Kosova:



<p>Kosovës:</p> <p>1.1. shqyrton dhe miraton planin afarist vjetor;</p> <p>1.2. shqyrton raportin afarist të vitit paraprak, jep mendime dhe propozime në të dhe bashkë me to, ia dërgon MF-së për shqyrtim dhe vendosje;</p> <p>1.3. në rastin e parashtrimit të raportit afarist nga viti paraprak dhe të planit afarist për vitin rrjedhës, i jep propozim MF-së, për përgatitjen e vendimit për sistemimin e mjeteve të realizuara;</p> <p>1.4. vendos për lëshimin dhe publikimin e tiketave;</p> <p>1.5. miraton rregullat e lojërave të fatit;</p> <p>1.6. jep iniciativa për miratim, ndryshim apo plotësim të dispozitave nga fushë veprimtaria e lojërave të fatit, të cilat ia paraqet MF-së; dhe</p> <p>1.7. MF-ja i propozon për të dhënë pëlqim për ushtrimin e përbashkët të lojërave të fatit me lotaritë e vendeve të tjera që ushtrojnë lojërat e fatit, dhe/apo me organizatat e specializuara.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Sistemimi i mjeteve të realizuara dhe bashkëpunimi i Lotarisë me lotaritë ndërkombëtare</b></p> <p>1. Vendimin për sistemimin e mjeteve të</p>	<p>Kosovo:</p> <p>1.1. analyzes and approves the annual business plan;</p> <p>1.2. analyzes the business report for the previous year, gives suggestions and ideas in it and along with it, submits it to MF for analysis and decision making;</p> <p>1.3. in case of submission of the business report for the previous year and the business plan for the following year, it gives suggestions to MF, to prepare the decision for systemizing the realized means;</p> <p>1.4. decides about the issuance and publication of tickets;</p> <p>1.5. approves the rules of Games of Chance;</p> <p>1.6. gives initiatives for the approval, modification or supplementation of the provisions from Games of Chance field of activity, which it represents to the MF;</p> <p>1.7. proposes to MF to give consent for a joint exercising of Games of Chance with the Lotteries of other countries, which exercise Games of Chance, and/or with specialized organizations.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>Systemizing the Realized Means and Cooperation of the Lottery with International Lotteries</b></p> <p>1. The decision for systemizing the means</p>	<p>1.1. razmatra i usvaja godišnji poslovanja;</p> <p>1.2. razmatra izveštaj o poslovanju iz prethodne godine, daje mišljenja i predloge na isti i uz te dostavlja ga MF-u za razmatranje i odlučivanje;</p> <p>1.3. u slučaju podnošenje izveštaja o poslovanju iz prethodne godine i poslovnog plana za tekuću godinu, daje predlog MF-a za pripremanje odluke o sistematizovanju realizovanih sredstava;</p> <p>1.4. odlučuje o izdavanju i objavljivanju tiketa.</p> <p>1.5. donosi pravila igara na sreću;</p> <p>1.6. daje inicijative za usvajanje, izmenu ili dopunu odredbi iz oblasti delatnosti igara na sreću, koje predstavlja MF; i</p> <p>1.7. MF predlaže da daje saglasnost za zajedničko vršenje igara na sreću sa lutrijama drugih zemalja koje vrše igre na sreću, i/ili sa specijalizovanim organizacijama.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Raspoređivanje ostvarenih sredstava i saradnja Lutrije sa međunarodnim lutrijama</b></p> <p>1. Odluku o raspoređivanje ostvarenih</p>
--	---	---



<p>realizuar në pajtim me nenin 22 të këtij ligji, e miraton MF-ja në afat prej tridhjetë (30) ditësh.</p> <p>2. Sipas ligjit, Lotaria e Kosovës mund të organizohet edhe në bashkëpunim me lotaritë e shteteve të tjera.</p> <p>3. MF-ja jep pëlqimin për organizimin e lojërave të lotarisë nga paragrafi 2. i këtij neni.</p> <p>4. Lojërat e lotarisë mund t'i realizojë Lotaria e Kosovës në bashkëpunim afarist me subjektet e tjera juridike të regjistruara si: tregtare, zejtare, hotelieri etj., ndër të tjera edhe për transaksionin e mallrave dhe të shërbimeve.</p> <p>5. Lotaria e Kosovës mund të jetë anëtare e EL (Lotarive të Shteteve Evropiane dhe Shoqata Totto) si dhe e shoqatave të tjera ndërkombëtare të lojërave të fatit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Lojërat e lotarisë</b></p> <p>1. Lojërat e lotarisë janë lojëra në të cilat më parë përcaktohet shuma e fondit të fitimeve dhe kategorizohen siç vijon:</p>	<p>realized according to the Article 22 of this Law is approved by MF within thirty (30) days.</p> <p>2. According to the Law, the Lottery of Kosovo can also be organized in cooperation with the Lotteries of other countries.</p> <p>3. MF gives the consent for the organization of Lottery Games from paragraph 2. of this Article.</p> <p>4. The Lottery Games can be realized by the Lottery of Kosovo in business cooperation with other legal registered subjects like: trade, artisan, catering etc, among other things, also for transaction of goods and services.</p> <p>5. The Lottery of Kosovo may be a member of the EL (European State Lotteries and Toto Association) and of other international associations for Games of Chance.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>Lottery Games</b></p> <p>1. Lottery Games are Games in which the amount of the winning funds is determined beforehand and they are categorized as follows:</p>	<p>sredstava u skladu sa članom 22. ovog zakona, donosi MF u roku od trideset (30) dana.</p> <p>2. Po zakonu, Lutrija Kosova može da se organizuje i u saradnji sa lutrijama drugih država.</p> <p>3. MF daje saglasnost za organizovanje lutrijskih igara iz stava 2. ovog člana.</p> <p>4. Lutrijske igre može da realizuje Lutrija Kosova u poslovnoj saradnji sa drugim pravnim subjektima registrovanim kao: trgovinski, zanatski, ugostiteljski i dr., između ostalog i za transakciju roba i usluga.</p> <p>5. Lutrija Kosova može biti član EL (Lutrija evropskih zemalja i Udruženje Totto), kao i drugih međunarodnih udruženja igara na sreću.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Lutrijske igre</b></p> <p>1. Lutrijske igre su igre u kojima se prethodno utvrđuje iznos dobitnog fonda i vrši se kategorizacija, i to:</p>
---	--	--



<p>1.1. lotaria tradicionale; 1.2. lojërat instant; 1.3. lojërat numerike; 1.4. lojëra të ngjashme ku rezultatet bazohen në rastësi; 1.5. tombola TV - bingo;</p> <p>2. Lojërat e fatit siç janë: lojërat në kazino, lojërat në automate dhe bastet, tombolla bingo në lokalet e mbyllura, prognoza sportive-Totto, Lotaria e Kosovës nuk mund t'i organizojë.</p> <p>3. Për organizimin e këtyre lojërave të lotarisë, sipas këtij neni nuk ka nevojë të bëhen pagesa të veçanta të rezervës fillestare të sigurimit dhe pagesa për licencë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Rregullat e lojërave të lotarisë</b></p> <p>1. Me rregullat e lojërave të lotarisë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e Lotarisë së Kosovës dhe të pjesëmarrësve në lojërat e lotarisë.</p> <p>2. Rregullat për ushtrim të lojës së lotarisë përmbajnë:</p> <p>2.1. emrin dhe selinë e organizuesit; 2.2. emrin, përshkrimin dhe kohëzgjatjen</p>	<p>1.1. traditional lottery; 1.2. instant win games; 1.3. numerical games; 1.4. similar games in which the results are based purely on chance; 1.5. tombola TV-bingo;</p> <p>2. Games of Chance such as: casino games, slot machines and betting, tombola -bingo in closed premises, sports prognosis-Totto, cannot be organized by the Lottery of Kosovo.</p> <p>3. For organizing such Lottery Games, according to this Article no special payments of initial provision of security and payments for license are to be made.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 12</b> <b>The Rules of Lottery Games</b></p> <p>1. The rules of Lottery Games define the rights and obligations of the Lottery of Kosovo and of the participants of Lottery Games.</p> <p>2. Rules for exercising Lottery Games include:</p> <p>2.1. name and seat of the organizer; 2.2. name, description and duration of the</p>	<p>1.1. tradicionalna lutrija; 1.2. instant igre; 1.3. numerike igre; 1.4. slične igre gde se rezultati baziraju na slučajnost; 1.5. TV tombola- bingo.</p> <p>2. Igre na sreću, kao što su: kazino igre, igre u slot-mašinama i kladionice, tombola bingo u zatvorenim prostorijama, sportska prognoza-Totto, Lutrija Kosova ne može organizovati.</p> <p>3. Za organizovanje ovih lutrijskih igara, prema ovom članu, nije potrebno da se vrši posebno plaćanje početne rezerve osiguranja i plaćanje za licencu.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 12</b> <b>Pravila igara na sreću</b></p> <p>1. Pravilima igara na sreću utvrđuju se prava i obaveze Lutrije Kosova i učesnika lutrijskih igara.</p> <p>2. Pravila za vršenje lutrijske igre sadrže:</p> <p>2.1. ime i sedište organizatora, 2.2 .ime, opis i trajanje igre na sreću;</p>
--	---	---



